

Asylum Support Partnership

help and advice



March 2011

Albanian

Jeni i varfër dhe në fund të procesit të azilit?

A ju është refuzuar aplikimi për azil nga Agjencia Britanike e Kufinjve (UK Border Agency - UKBA)? Nuk keni pasur sukses me apelimet për azil? Nëse jeni mbështetur tek ndihma e dhënë nga shteti – Agjencia Britanike e Kufinjve (UKBA), atëherë UKBA ka ndërprerë ndihmën financiare për ju. Kur azil kërkuesit nuk kanë më të drejtë të apelojnë, ata konsiderohen nga UKBA si ish – azil kërkues.

Përgjithësisht, autoritetet presin prej jush që të largoheni nga Britania e Madhe vullnetarisht, ose në të kundërt ata do të marrin masat për t'ju larguar. Nëse UKBA nuk mund t'ju largojë nga Britania e Madhe menjëherë, ju mund ta gjeni veten pa strehim dhe pa mbështetje financiare.

Nëse ky është rasti juaj, ju mund të aplikoni tek UKBA për një paketë ndihme financiare shumë të kufizuar e njohur si "Ndihma Seksioni 4" ('Section 4 support'). Kjo ndihmë financiare vlen më tepër për ish-azil kërkuesit që janë pa fëmijë. Azil kërkuesve me fëmijë nën moshën 18 vjeç vazhdohet t'i jepet ndihmë deri në momentin që largohen nga Britania e Madhe.

Cfarë është ndihma e Seksionit 4?

Nëse jeni i kualifikuar për ndihmën e Seksionit 4, atëherë UKBA do t'ju sigurojë strehim me ushqim ku vetë-shërbehesh, si dhe kartën 'Azure' për këtë ushqim dhe për artikuj të konsumit të përditshëm si ato të higjenës personale. Për këtë arsye nuk do të merrni para në dorë. Ndihma juaj financiare javore do t'i ngarkohet kartës 'Azure'. Kjo kartë mund të përdoret në disa dyqane të tilla si Asda dhe Tesco për të kryer blerjen e artikujt më të nevojshëm për ju si psh ato të higjenës personale, ose ushqim dhe artikuj pastrimi. Për më tepër informacion lidhur me pagesat që mund të kryen nëpërmjet kartës Azure, lexoni fletëpalosjen me titullin "Ndihmë Seksioni 4 për Kartën e Pagesave Azure " tek <http://languages.refugeecouncil.org.uk/english/summary.htm#26>

Ka shumë mundësi që ju do të strehoni në një zonë që ndodhet jashtë Londrës. Gjithashtu, do ju jepet vetëm një mundësi akomodimi dhe nëse nuk e pranoni këtë mundësi UKBA do të ndërpresë ndihmën ndaj jush. Vetëm në raste të jashtëzakonshme, azil kërkuesit që marrin ndihmë nën Seksionin 4 mund të vendoset më pranë anëtarëve të tjerë të familjes.

Ka shumë mundësi që ju do të ndani vendin ku strehoni me persona të tjerë. Nëse ekzistojnë arsye të veçanta për të cilat ndarja e strehimit është e papërshtatshme për ju, atëherë këto arsye do t'i transmetohen UKBA me shkrim.

Fletëpalosje të tjera janë të disponueshme tek <http://languages.refugeecouncil.org.uk>

Asylum Support Partnership is a partnership project hosted by the British Refugee Council
British Refugee Council, (commonly called the Refugee Council) is a company limited by guarantee registered in England and Wales, [No 2727514] and a registered charity, [No 1014576].
Registered office: 240-250 Ferndale Road, London SW9 8BB, United Kingdom, VAT no: 936 519 988



Cilat janë kriteret për Ndhmën Seksioni 4 ?

UKBA përdor kritere shumë të rrepta për të vendosur nëse juve mund t'ju jepet ndihma e Seksionit 4. Kushti i parë është që ju duhet të jeni i varfër, gjë që do të thotë se nuk keni strehim dhe/ose mundësinë për të blerë ushqim. Ju duhet të shpjegoni se në ç'mënyrë jeni vetë financuar deri tani dhe duhet të siguronit prova për të vërtetuar shpjegimin tuaj.

Gjithashtu ju duhet të tregoni se plotësoni të paktën **njërën** nga kushtet e mëposhtme:

1. Ju po ndërmerrni hapa serioze për t'u larguar nga Britania e Madhe, ose jeni aktualisht në pozita për të bërë diçka të tillë.
2. Ose, nuk jeni në gjëndje të largoheni nga Britania e Madhe për shkak të ndonjë vështirësie fizike që ju pengon të udhëtoni drejt vendit tuaj, për shembull mund të jeni i sëmurë, ose shtatëzane në muajn e fundit.
3. Ose, keni aplikuar dhe ju është dhënë leja për të dalë para Gjykatës së Lartë (High Court) për rishikim ligjor për të kundërshtuar refuzimin e UKBA ndaj aplikimit tuaj për azil. Vini re që në Skoci, ju vetëm duhet të tregoni se keni aplikuar për rishikim ligjor. Gjithashtu, ju mund të keni një përfaqësim të jashtëzakonshëm me UKBA në rastet kur keni një pretendim të ri për të kërkuar azil.
4. Ose, ju nuk keni mundësi për të udhëtuar, sepse nuk ka asnjë itinerar të sigurtë për t'u kthyer. Sipas UKBA, aktualisht nuk ka asnjë vend për të cilin vlen ky argument. Përfaqësuesi juaj ligjor ose një këshillues i Shërbimit për Këshillim dhe Ndhmë (One Stop Service) do mund t'ju thotë nëse diçka e tillë ka ndryshuar.
5. Ose, sigurimi i strehimit është i nevojshëm për të shmangur shkeljen e të drejtave tuaja. Për shembull, nëse dorëzoni një aplikim të ri dhe informacioni në këtë aplikim ndryshon nga aplikimi juaj i parë, atëherë ndihma e Seksionit 4 duhet t'ju jepet.

UKBA merr parasysh meritat individuale të secilit aplikim për ndihmën e Seksionit 4, dhe do ju kërkojë që të sillni dokumentacionin e duhur për të vërtetuar arsyet pse ju nuk keni mundësi që të ktheheni në shtëpi ose të udhëtoni. Ky dokumentacion mund të jetë një letër nga doktori, ku deklarohen arsyet pse ju nuk jeni në gjëndje të udhëtoni, ose vërtetim në shkresë ku thuhet që ju keni marrë lejen për rishikim ligjor para Gjykatës së Lartë.

Si mund të aplikojë për ndihmën e Seksionit 4?

Për të aplikuar për ndihmën e Seksionit 4, azil kërkuarit kanë në dispozicion dy formularë.

Formularët e aplikimit për ndihmën e Seksionit 4 janë të disponueshme tek:

<http://www.ukba.homeoffice.gov.uk/asylum/support/apply/section4/>

Kontakti Shërbimit për Këshillim dhe Ndhmë dhe ata do t'ju këshillojnë se cilin formular të përdorni, dhe do ju ndihmojnë për të plotësuar formularin e duhur. Këshilluesi i Shërbimit për Këshillim dhe Ndhmë do dërgojë formularin tuaj të aplikimit tek UKBA, që të merren në shqyrtim dhe do t'ju informojë për vendimin e marrë. Gjithashtu, ata mund t'ju informojnë për ndihmë tjetër financiare për të cilën ju mund të keni nevojë, për shembull për shpenzimet e transportit për udhëtimin tuaj nga vendi ku jeni strehuar tek qendra e raportimit. Për informacion lidhur me pikat më të afërta të Shërbimit për Këshillim dhe Ndhmë lexoni në fund të kësaj fletëpalosje.

Gjithashtu, përveç Shërbimit për Këshillim dhe Ndhmë, përfaqësuesi juaj ligjor, qendra lokale ligjore, Këshillimi për Qytetarët (Citizens Advice) ose organizata e komunitetit të refugjatëve, mund t'ju ndihmojnë që të aplikoni për ndihmën e Seksionit 4.

Ju lutem vini re, pasi të keni marrë një letër nga UKBA ku deklarohet që ndihma juaj e mëparshme është ndërprerë, ju duhet të aplikoni menjëherë për ndihmën e Seksionit 4.

Ju duhet të firmosni formularin e aplikimit për të konfirmuar që kuptoni afatet dhe kushtet e marrjes së ndihmës së Seksionit 4:

- Ndhimja e Seksionit 4 ka të bëjë me strehim bazik.

- UKBA zakonisht do t'ju sigurojë strehim jashtë Londrës, gjë që do të thotë se ju do të zhvendoseni, përveç rasteve të veçanta, që justifikojnë arsyet pse ju duhet të strehoheni në Londër.
- UKBA do të shqyrtojë rregullisht rastin tuaj nëse ende kualifikoheni për ndihmën e Seksionit 4.
- Nëse ju merrni ndihmën e Seksionit 4 dhe autoritetet bëjnë një kërkesë të arsyeshme për të marrë informacion prej jush, juve do ju duhet t'i bindeni kësaj kërkesë.

Nëse aplikimi juaj është i suksesshëm, UKBA do t'i duhen pak ditë për t'ju siguruar strehimin, dhe gjithashtu do ju dërgojë një biletë udhëtimi për të mbërritur në atë strehim.

Për sa kohë do të marrë ndihmë nga Seksioni 4?

UKBA do të shqyrtojë rregullisht kualifikimin tuaj për Seksionin 4. Ata do të kontrollojnë nëse kushtet tuaja kanë ndryshuar dhe nëse ka ende pengesa që ju pengojnë juve për t'u larguar nga Britania e Madhe.

Ç'ndodh kur aplikimi im për Seksionin 4 nuk aprovohet?

Nëse UKBA refuzon aplikimin tuaj për ndihmën e Seksionit 4, ju keni të drejtën për të apeluar kundër refuzimit dhe Shërbimi për Këshillim dhe Ndhimë do ju ndihmojë të apeloni. Ju duhet të apeloni brenda një periudhe kohore tepër të shkurtër.

Ju mund të aplikoni përsëri nëse gjendja juaj ka ndryshuar që nga aplikimi i fundit i bërë për ndihmën e Seksionit 4. Gjithashtu, ju mund të aplikoni përsëri, nëse keni prova të reja që mbështesin aplikimin tuaj për azil. UKBA do të kontrollojë nëse ju jeni me të vërtetë i/e varfër dhe do ju pyesë, se si keni arritur të mbijetoni që nga periudha e dorëzimit të aplikimit të fundit.

Çfarë lloje tjetër ndihme është e disponueshme?

Nëse keni vështirësi fizike apo vështirësi për të mësuar, dëmtim të dëgjimit apo të shikimit, probleme të shëndetit mendor apo sëmundje kronike, atëherë ju duhet të zbuloni nëse mund të merrni ndihmë nga departamenti i shërbimeve shoqërore (social services) të pushtetit vendor. Juve apo dikush tjetër në emrin tuaj duhet t'i kërkojë departamentit të shërbimeve shoqërore të pushtetit vendor për marrjen në konsideratë të këtyre nevojave.

Nëse ju ndodheni në fund të procesit tuaj të azilit, dhe nuk keni më të drejtë për të apeluar, ju është refuzuar ndihma e Seksionit 4, dhe nuk keni asnjë mënyrë për t'u mbështetur financiarisht, ju mund të kërkonit ndihmë nga organizatat bamirëse. Në disa raste, organizatat lokale komunitare të tilla si komuniteti i refugjatëve apo grupet e besimit mund t'ju sigurojnë një vakt të ngrohtë, porcione ushqimi, artikuj të higjienës personale ose rroba.

Për të gjetur organizatat bamirëse që mund t'ju ndihmojnë në këtë mënyrë, mund të pyesni Shërbimin për Këshillim dhe Ndhimë, që ndodhet më pranë jush, zyrat lokale të Kryqit të Kuq (Red Cross), Këshillimin për Qytetarët (Citizens Advice) apo qendrat lokale të këshillimit. Ose mund të pyesni në një bibliotekë për detajet e kontakteve. Pushteti juaj vendor ndoshta mund të ketë ngritur një shërbim për të ndihmuar azil kërkuarit, të cilët janë bërë të varfër në këtë mënyrë.

Shërbimi për Këshillim dhe Ndhimë

Shoqata bamirëse të tilla si Shërbimi për Refugjatët në Anglinë Veriore (North of England Refugee Service), Aksion për Refugjatët (Refugee Action), Këshilli për Refugjatët (Refugee Council), Këshilli Skocez për Refugjatët (Scottish Refugee Council) dhe Këshilli Refugjat i Uellsit (Welsh Refugee Council) janë shoqatat kryesore të cilat ofrojnë ndihmë dhe këshillim për azil kërkuarit dhe refugjatët. Këto shoqata ofrojnë informacione dhe këshilla, lidhur me çështjet si akomodimi, ndihmë për

subvencione, azil, shëndetin dhe të çështje të tjera, nëpërmjet Shërbimit për Ndhinë dhe Këshillim në rajone të ndryshme të Britanisë.

Ju do mund t'i gjeni kontaktet e Shërbimi për Ndhinë dhe Këshillim pranë zonës tuaj tek:
<http://languages.refugeecouncil.org.uk/english/services.htm>

Asylum Support Partnership consists of:

North of England Refugee Service, charity number: 1091200 www.refugee.org.uk

Refugee Action, charity number: 283660 www.refugee-action.org.uk

Refugee Council, charity number: 1014576 www.refugeecouncil.org.uk

Scottish Refugee Council, charity number: SC008639 www.scottishrefugeecouncil.org.uk

Welsh Refugee Council, charity number: 1102449 www.welshrefugeecouncil.org